



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria e Kosovës - Vlada Republika - Government of Kosovo MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY			
Grupimi Q. J. Nr. Gr. J. Nr.	01	N. Pr. N. Pr. Nr. Pr. Nr.	47
T. Shpreh. T. Shpreh. Nr. T. Shpreh. Nr.	2	Date Datum Date	15.02/2010
Prishtinë / 2			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në bazë të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 paragrafi 10.2 pika (a), nenit 14 paragrafi 14.1 dhe 14.3 të Ligjit Nr. 2004/5 Për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë si dhe nenit 5 të Ligjit Nr.02/L-20 Për Kërkesat Teknike të Produkteve dhe Vlerësimin e Konformitetit, me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/21 Për cilësinë e derivateve të lëngëta të naftës, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 03/2010

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV Nr. 2008/21
PËR CILËSINË E DERIVATEVE TË LËNGËTA TË NAFTËS**

Neni 1
Qëllimi

Në Udhëzimin Administrativ Nr.2008/21 Për cilësinë e derivateve të lëngëta të naftës, në nenin 2 pas nënparagrafit 1.11. shtohet edhe nënparagrafi 1.12. që shprehet me këtë tekst si vijon: "Gazi i Lëngëzuar i Naftës (në vazhdim GLN)".

Neni 2

Në nenin 3 të të njëjtit UA.Nr.2008/21 të përkufizimet shtohet edhe një përkufizimi i ri me emërtim: "GLN" me këtë tekst si vijon: "Gazi i lëngëzuar i naftës (GLN) anglisht LPG (*Liquefied Petroleum Gas*), respektivisht gazi për automjete i cili është përzierje e gazrave të hidrokarbureve dhe përdorët si lëndë djegëse për automobila dhe shfrytëzues tjerë. GLN është një emërim i ri për propan-butanin".

Neni 3

1. Në UA.Nr.2008/21 pas nenit 18 shtohet neni 19 me këtë tekst si vijon: "Gazi i Lëngëzuar i Naftës"GLN është përzierje e hidrokarbureve me 3 dhe 4 atome të karbonit, propan, n-butan, izo butan, propen, buten etj. Emri GLN rrjedh nga ajo se në temperaturë normale dhe në shtypje të ulët 2-8 bar lehtë kalon në gjendje agregate të lëngët. GLN është pa ngjyrë, shumë i ndezshëm dhe eksplodues si dhe ka erë karakteristike.

GLN digjet vullshëm duke liru sasi të madhe të nxehtësisë ndërsa produkti i djegies është dyoksidi i karbonit dhe avulli i ujit. Temperatura maksimale e ndezjes me ajër është rreth 1900 °C. Me ajrin krijon përzierje eksplozuese e cila mund të ndizet në prani të flakës së hapur. Në krahasim me gazrat tjera ndezës kufiri eksplozues është përafërsisht 2 ÷ 9 vol% (përzierja propan-butan 35:65), për propan 2,1 ÷ 9,5, kurse butan 1,9 ÷ 8,5. Numri oktanik i GLN sillet rreth 90-110 ndërsa aflësia e ulët termike Hu 25,5MJ/dm³ për propan të pastër dhe 28,7MJ/dm³ për butan të pastër.

2. Vlerat kufizuese të cilësisë së gazit të lëngëzuar të naftës si dhe standardet apo metodat për përcaktimin e tyre paraqiten në tabelë si vijon:

Treguesi i cilësisë	Parametri me njësi	Standardi ose metoda
Numri oktanik motorik	90.5 min	Përbërja sipas ISO 7941, llogaritja sipas EN 589 Aneksi B
Shtypja e avujve në 40 °C	800 kPa min-1530 kPa max	ISO 8973
Mbetja e pa avullueshme	2.0 max. Mol %	ISO 7941
Mbetja e avullueshme	100 mg/kg	JLPGA-S-03 metoda masore 105°C
Ndryshkja, shirit bakri	Klasa e parë	EN ISO 6251
Sulfidi i Hidrogjenit	-	EN ISO 8819
Sulfuri	50 mg/kg	ASTM D2784
Dienet	0,3 mol % max	ISO 7941
Përbërja e lagështisë	S'ka në 0°C	EN 589
Era (aroma)	20%	EN 589 Anksi A

Neni 4

Në nenin 32 paragrafi 2 të të njëjtit UA.Nr.2008/21 fjalja: “Inspektoratit brenda MTI-së” zëvendësohet me fjalinë: “Zyra për licencim, rregullim dhe vëzhgim të sektorit të naftës”.

Neni 5

Dispozita kalimtare

Ky Udhëzim Administrativ është pjesë përbërëse e Udhëzimit Administrativ Nr.2008/21 Për cilësinë e derivateve të lëngëta të naftës.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa do të zbatohet 15 ditë pas nënshkrimit.

Prishtinë, 12.02.2010

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë
Lutfi ZHARKU

